

## **Bregu: Një treg për të 6 -të vendet e Ballkanit Perëndimor është në ndërtim e sipër dhe ne tashmë e kemi bazën.**

*Podkast i Sekretares së Përgjithshme të RCC, në Samitin e ardhshëm Dixhital të Ballkanit Perëndimor*

Piramida, siç e përshkroi Kadare, është “dominimi i zhurmës, ngushtimi i mendjes së saj; një monotoni... Por kujdestari më i besueshëm i Faraonit.”

E ngritur së pari si mauzoleum për nder të Enver Hoxhës, diktatorit të Shqipërisë, Piramida e Tiranës do të kthehet tashmë në qendrën më të madhe rajonale të transformimit dixhital në Ballkanin Perëndimor. Ndaj jemi sot këtu, tek simboli i duhur që pëshfaq pëmbysjet e dy realiteteve, kohëve krejt të ndryshme e të largëta nga njëra- tjetra. Pra nuk mund të kishte simbolikë më të bukur se kjo ndërtesë, kur flitet për të ardhmen dixhitale të Ballkanit Perëndimor, që do të jetë dhe thelbi i bashkëpunimit rajonal dhe forca nxitëse për krijimin e një tregu të përbashkët, për të 6-të vendet e BP, që është në ndërtim e sipër. Ne tashmë e kemi bazën. Ballkani Perëndimor hyri në fillimin e korrikut në epokën e roaming pa pagesë. Por kur udhëtojmë nga Ballkani drejt vendeve të BE- së, paguajmë 43 herë më shumë në roaming se të tjerët. Ndaj qëllimi tjetër i madh dhe i shpejtë i yni është që çmimet e roaming midis Ballkanit Perëndimor dhe BE-së, brenda 5 viteve të ardhshme, të ulen gradualisht derisa të afrohen me ato vendore. Kemi kohë që e kemi filluar punën për këtë.

Në Podgoricë do të mbahet samiti i 4 -t dixhital i Ballkanit Perëndimor. RCC ndjehet krenare që është pjesë e kësaj historie. Përveç fillimit të shpejtë të procesit të zvogëlimit të tarifave të roamingut WB-BE, ne do të jemi të fokusuar për përmirësimin e infrastrukturës sonë dixhitale. Qëllimi më i rëndësishëm është sigurimi i lidhjeve të internetit për 95% të familjeve deri në 2024.

Më pas, do të kemi në fokus shërbimet elektronike. Pandemia na tregoi se sa e rëndësishme dhe e domosdoshme është të përgatitesh për ta pasur çdo proces dixhital Mbase nuk ju kujtohet, por vitin e kaluar gjatë sesionit tonë në Balkathon ne vlerësuar 6 idetë më të mira inovative nga ky rajon. Të gjitha ato ide do të jenë të pranishme në Podgoricë. Njëra prej tyre është vendase. Është një ekip malazez që tashmë ka përgatitur *Pokupin*, si një platformë dixhitale e cila ofron shërbim taksi për smartphones, dhe të cilin e kam tashmë me vete.

Axhendat Dixhitale do të jenë gati për Samitin e ardhshëm dixhital si për shembull ; blerja elektronike ose njohja e shërbimeve të besuara, rrjedhja e lirë e të dhënave, e cila konsiderohet si liria e pestë e një tregu të përbashkët.

Kjo është e përmbledhur, por jo e gjitha.

Qëndroni të sintonizuar, 11-13 tetor nga Podgorica